

1. A ka ministria një regjistër të dëmeve të shkaktuara në bujqësi në dy vitet e fundit nga dukuritë natyrore? Nëse po, sa dëme janë identifikuar, sa ka qenë vlera në lekë për secilin dëm?

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka të dhëna mbi dëmet e shkaktuara si efekt i kushteve atmosferike (përmytjeve, shirave të fortë, breshërit, rrëshqitjeve të tokës, temperaturave të larta të cilat shkaktojnë zjarre) përsa i përket kulturave të dëmtuara.

Gjatë dy viteve të fundit, dëme janë identifikuar pothuajse në të gjitha qarqet në kulturat bujqësore nga breshëri (më datë: 25.5.2020; 8.6.2020; 23.7.2020; 14.5.2021), nga zjarret (më datë: 10.9.2021; 24.7.2021).

MBZHR nuk llogarit dëmin në vlerë, pasi kjo procedurë sipas Ligjit Nr. 45/2019, datë 18.7.2019 “Për mbrojtjen civile”, është kompetencë e bashkive, të cilët pas llogaritjes së dëmit, kryejnë vlerësimin dhe procedojnë me dëmshpërblimin.

Bashkëlidhur informacioni i dëmeve të shkaktuara në bujqësi.

2. Cila ka qenë politika që ka ndjekur ministria sa u takon këtyre rasteve nga dëmet natyrore? A ka pasur dëmshpërblime? Nëse po a mund të na vihen në dispozicion të dhënat për secilin rast?

Në zbatim të ligjit kompetencë e Ministrisë së Mbrojtjes.

Sa i përket MBZHR, referuar Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe VKM-së Nr. 431, datë 15.7.2021, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është krijuar njësi organizative në nivel sektori “Sektori i Emergjencave Civile”. Me krijimin e këtij sektori të ri është grumbulluar nga strukturat e varësisë informacioni me të dhënat për dëmet dhe humbjet nga fatkeqësitë natyrore në fushën e përgjegjësisë së ministrisë për të gjithë territorin e Shqipërisë e cila mirëmbahet përditësohet dhe dërgohet pranë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi. Dëmshpërblimi përballohet nga bashkitë dhe në rast se tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë kompesimi kryhet nga AKMC.

3. Në afatgjatë, si do të ndihmojë ministria në minimizimet e dëmeve në bujqësi? A ka një plan? Një strategji?

Sigurimet në bujqësi, është një proces i rëndësishëm dhe i vështirë. MBZHR do të krijojë kushte lehtësuese për hartimin e masave mbështetëse për fermerët, si dhe rritjen e kreditimit në bujqësi. Po ashtu, përmes investimeve në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit. Në zbatim të Ligjit Nr. 45/2019, datë 18.7.2019 “Për mbrojtjen civile”, në Ministri është ngritur sektori i emergjencës dhe në bashkëpunim me AKMC ky sektor është duke punuar për hartimin e Planit të

Emergjencave. Gjithashtu, janë ngritur grupet ndërinstitucionale të punës në nivel teknik dhe politik për hartimin e Planit dhe të Strategjisë Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

4. Cilat fenomene natyrore kanë sjellë më shumë dëme në bujqësinë shqiptare?

Nga të dhënat administrative rezulton se reshjet kanë shkaktuar dëmet më të konsiderueshme në sektorin e bujqësisë dhe po ashtu dhe zjarret.